



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-111
Prishtinë, më 6 korrik 2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së kryesisë së kuvendit, të mbajtur më 8 korrik 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku dhe Slllobodan Petroviq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ismet Beqiri, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Branislav Grbiç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

I. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

1. Me kërkesë të Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, Kryesia vendosi që me 12 korrik 2010, në ora 10:00 të mbaj mbledhjen plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën presidenti do të paraqet fjalimin vjetor.
2. Kryesia vendosi që, pas fjalimit vjetor të Presidentit të vazhdohet me mbledhjen plenare në ora 11:00 h, sipas këtij

Rendi të ditës

1. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën tatimore dhe procedurat,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bankën Qendrore të republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010,

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:15.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale